



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:080453

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05769197

Kom.Dh.Shk.II.nr.1602/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Sole Kosova Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, e përfaqëson me autorizim Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Fushë Kosovë, Zona Industriale, e përfaqëson me autorizim Avokatura Shtetëror, sipas dokumentit të besueshëm përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2594/22 të datës 20.10.2023, me datën 03.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2594/22 të datës 20.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.2594/22 të datës 20.10.2023, në dispozitiv, e ka refuzuar prapësimin e debitorit Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Fushë Kosovë, ndërsa Urdhërin Përmbartimor P.nr.645/22 i datës 22.11.2022 i Përmbartuesi Privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj të mbetet në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbare dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe për shpenzimet e procedurës me propozimin që të aprohet ankesa e kreditorit, të anulohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2594/22 të datës 20.10.2023 dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesën e debitorit, duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar KPPP.nr.2594/22 të datës 20.10.2023, si dhe të obligohet kreditori që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbare.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 22.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1270/17 të datës 02.06.2021, që të paguaj për shumën e borxhit debitorit në shumë prej 113,348.31€, me kamatë 8%, si dhe përfshirë shpenzimet të procedurës e përmbaremit në shumë prej 487.00 euro.

Përmbareuesit privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbare të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbaremit në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1270/17 të datës 02.06.2021, e cilat paraqet dokument përmbareuese në bazë të nenit 29 par.1.2 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuat se nuk kemi të bëjmë me aktvendim të drejtë dhe një vendim i tillë do ti sjell shumë pasoja tek debitori, duke mos marr parasysh edhe të gjitha dëshmitë dhe e faktet e prezantuara nga debitori, të cilat i ka refuzuar gjykata pa ndonjë arsyetim të mirëfilltë, andaj ka propozuar që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përmbarimor.

Kreditore ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar me asnjë prove dhe kreditore ka bërë vetëm sa për të bërë prolongimin e procedurës përmbarimore dhe nuk ka shkaqe nga neni 71 të LPP-së, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Lidhur me prapësimin, Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.2594/22 të datës 20.10.2023, në dispozitiv, e ka refuzuar prapësimin e debitorit Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Fushë Kosovë, ndërsa Urdhërin Përmbarimor P.nr.645/22 i datës 22.11.2022 i Përmbaruesi Privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *"Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër."* Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1270/17 të datës 02.06.2021, mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditore, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1270/17 të datës 02.06.2021, mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 36, paragrafin 1 të LPP-se, sipas të cilit përcaktohet se: *"Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri"*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *"Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë"*, ngase i njëjti është bërë i plotfuqishëm së datës 06.10.2022 dhe mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 07.11.2022.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës debitorit, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarimor, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës, pasi që në këtë procedurë kemi të bëjmë me parimin e rigozitetit formal siç si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimit ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 21, 22 dhe 27 të LPP-së.

Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1602/23, me datë 03.06.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti